

V E N D I M
Nr. 154, datë 7.4.2000

PËR LICENSIMIN E VEPRIMTARIVE PRODHUESE NË INDUSTRIJË JUSHQIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Licensimi i personave fizikë dhe juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari prodhuese në industrinë jushqimore, të bëhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

2. Licensimi i veprimtarisë prodhuese realizohet me dhënien e lejes “Për ushtrimin e veprimtarisë prodhuese në industrinë jushqimore”.

Afati i lejes është 5 vjet. Kjo leje mund të përsëritet dhe të hiqet, në përputhje me rregullat në fuqi.

3. Veprimtaritë prodhuese të industrisë jushqimore, që licensohen, përfshijnë degët:

- a. Metalurgji-mekanike;
- b. Lëkurë-këpucë
- c. Tekstil-konfeksione;
- ç. Gomë-plastike;
- d. Qelq-qeramike;
- dh. Dru-letër;
- e. Kimikate të tjera.

4. Subjektet, të cilat kërkojnë të zhvillojnë veprimtari prodhuese në degët e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, duhet të plotësojnë specifikimet teknike dhe të zbatojnë rregullat teknike, përkatëse.

Kontrolli i zbatimit të rregullave teknike bëhet nga inspektoriatet dhe nga organet e specializuara, shtetërore.

5. Afati i pajisjes së subjekteve me lejen “Për ushtrimin e veprimtarisë prodhuese në industrinë jushqimore” është 30 ditë nga data e paraqitjes së dokumentacionit përkatës.

6. Subjektet, të cilat sot ushtrojnë veprimtari prodhuese në industrinë jushqimore pa lejen përkatëse, janë të detyruara të pajisen me leje deri më 31.12.2000. Vazhdimi i kësaj veprimtarie pa lejen përkatëse pas datës së mësipërme është i paligjshëm.

7. Pikat 1.2 e vendimit nr.295, datë 13.4.1994, të Këshillit të Ministrave, “Për forcimin e kontrollit cilësor në prodhimin, ruajtjen, transportimin dhe tregtimin e mallrave jushqimore”, shfuqizohet.

8. Vendimi nr.198, datë 2.5.1997, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.621, datë 20.12.1993, “Për kompetencat në dhënien e lejeve për ushtrimin e veprimtarive në fushën e transportit”, ndryshuar me vendimin nr.763, datë 11.11.1996, shfuqizohet.

9. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të nxjerrë udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta